



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Rruga "Abdi Toptani", nr.2, Tiranë; Tel: 04251-267

E-mail: klsh.org.al; Eeb-site:ëëë.klsh.org.al

Nr. 1096/4 Prot.

Tiranë, më 14/12/2018

V E N D I M
Nr.191 Datë 14.12.2018

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË "MBI ZBATIMIN E PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË, NË AKTIVITETIN EKONOMIKO FINANCIAR, ZBATIMIN E PROJEKTEVE ME FINANCIM BUXHETI DHE DONATORË VENDAS E TË HUAJ, MONITORIMI E MBROJTJA E MJEDISIT NË ZONAT E MBROJTURA", për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 30.09.2018

Nga auditimi i ushtruar për vlerësimin e veprimtarisë financiare me kuadrin rregullator në fuqi, duke vlerësuar nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin për buxhetin, më aktet përkatëse ligjore e nën ligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe projektet e implementuara nga kjo njësi publike në fushën e mbrojtjes së mjedisit në Zonat e mbrojtura me financime nga donatorë të huaj e vendos dhe nga buxheti i shtetit etj. Rezultoi që veprimtaria e subjektit të audituar, nuk ka qenë plotësisht efektive në drejtim çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, administrimin dhe dokumentimin e lëvizjes së aktiveve, pamjaftueshmërinë e eksperiencës menaxheriale në përmbushje të funksioneve si entitet i ri, me ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm të florës, faunës, ekosistemeve, nxitjes e mbështetjes së zhvillimit të turizmit, pamjaftueshmërinë e burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme (si nga të ardhurat e veta, nga buxheti dhe nga donatorët) krahasuar me shtrirjen territoriale në të gjithë vendin, mungesë bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kanë në pronësi sipërfaqe të mëdha të zonave të mbrojtura së bashku me sipërfaqe ujqore të brendshme e detare etj.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit

nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në aktivitetin ekonomik financiar, zbatimin e projekteve me financim buxheti dhe donatorë vendas e të huaj, monitorimi e mbrojtja e mjedisit në zonat e mbrojtura”, të ushtruar në AKZM Tiranë me programin e auditimit nr.1086/1, datë 17.09.2018 për periudhën 01.01.2016 deri më 30.09.2018.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Konkluzione/Opinion:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në standardet e INTOSAI-t dhe Manualit të Përputhshmërisë të KLSH-it, i kryer në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM) Tiranë, rezultuan devijime nga kuadri ligjor rregullator në fuqi (kriteret) dhe konkretisht:

a. Ngadalësi dhe shkelje afatesh në hartimin, diskutimin me grupet e interesit dhe miratimin e akteve nënligjore të formës së VKM-ve dhe të udhëzimeve, urdhëresave dhe miratimin e tyre përcaktuar për përbushjen e zbatimit të ligjit nr.81/2017, datë 4.5.2017 “Për zonat e mbrojtura”, i cili fikson si afat fundor i plotësimit dhe miratimit muajin prill 2019, referuar datës së krijimit të AKZM me VKM nr.102, datë 06.02.2015, mangësi këto që kanë sjellë si pasojë :

-Pamjaftueshmërinë e eksperiencës menaxheriale në përbushje të funksioneve si entitet i ri, me ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm të florës, faunës, ekosistemeve dhe nxitjes e mbështetjes së zhvillimit të turizmit në Zonat e mbrojtura, pamjaftueshmërinë e burimeve të nevojshme dhe të mjaftueshme, si nga të ardhurat e veta, buxheti por dhe mungesa e Donatorëve vendas e të huaj, krahasuar me nevojën që ka dhe shtrirjen territoriale në të gjithë vendin, sipërfaqen e konsiderueshme të shtrirjes së zonave të mbrojtura, ku pjesa dërmuese territoriale është në pronësi të pushtetit vendor, por dhe të sipërfaqeve ujore të brendshme e detare. Mungesë bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të tjera si IKMT, IVKMT-të e bashkive, Drejtoritë Rajonale të Tatim Taksave dhe organet e rendit.

-Mungesa e nxjerrjes së 5 akteve nënligjore (VKM), si dhe udhëzimeve e rregulloreve përkatëse të lidhura me kriteret e punësimit, me identifikimin, caktimin, emërtimin e tarifave dhe të ardhurave nga përdorimi i ZM-ve për funksione aktivitetesh me larmi të ndryshme argëtuese e kurative, vizita turistike studimore etj.

b. Projektet apo marrëveshjet me financime nga donatorët e huaj të trashëguara me periudhë kohe që nga viti 2008(para10 vjetësh), të përfunduara nga ish ministritë, si: Ministria e Mjedisit, Ministria e Financave miratuar e ratifikuar në Kuvend, kanë të përcaktuar në mënyrë eksplicite auditimin nga auditues të jashtëm të zgjedhur e të përcaktuar prej vetë donatorit; pra që ka pamundësuar edhe më parë auditimin nga KLSH-it; rrjedhur kjo nga hapësirat ligjore për auditim të shprehura në këto marrëveshjeve dhe krahasuar me nenin 15/ë të ligjit nr.154/2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” i cili thotë se: *ë “Në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, t’u kërkojë personave juridikë, ku shteti disponon me shumë se 50 për qind të aksioneve ose kur huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti, të cilët posedojnë dokumente shkresore apo elektronike që konsiderohen të nevojshme për kryerjen e procesit të auditimit, që t’i paraqesin ato, sipas kërkesës tek audituesit përgjegjës”.*

c. Në pasqyrat financiare (bilancet kontabël) të vitit 2016 dhe 2017, nuk janë pasqyruar e përfshirë në formularin nr.1 në llogarinë 210 vlera për toka, troje dhe terreneve që u përkasin llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione, nuk janë pasqyruar e kontabilizuar në klasën IV-të “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët”, në llogarinë 468 të vlerës debitore të pashlyera të qerasë së objekteve, me kontrata me afat

shtrirje kohore mbi 10 vjet, që janë dhe objekt regjistrimi në ZVRPP.

d. Në mbajtjen e ditarit të Bankës viti 2016,2017 dhe 9/mujorin 2018 u konstatuan në **66 raste-numra** parregullsi e mangësi në identifikimin dhe regjistrimin e urdhër shpenzimeve të lidhura me përsëritje të numrave, ngatërrimit të rendit kronologjik, përdorimit të numrave me fraksion. Megjithëse urdhër shpenzimet mbajnë të njëjtin numër dhe datë, ato paraqesin dhe individualizojnë ngjarje dhe kryerje shpenzimesh reale të veçanta, individualisht të përcaktuara me shifra vlerore të ndryshme, por rezervohemi në të drejtën e dhënies së opinionit me gjithë rakordimet periodike të kryera me Degën e Thesarit.

e. Janë kryer shpenzime me dokumente justifikuese me mangësi e jo të plota në periudhën viti 2016-9/mujorin 2018 për parkun, për 84 raste të mjetëve tokësore detare, si në procedurat e marrjes në dorëzim të mallrave e shërbimeve, ashtu dhe në ndjekjen e shpenzimeve, blerje mallrash me mosndjekje e zbatim të specifikimeve teknike në vlerën totale **2,818,923 lekë**, nga të cilat: për mirëmbajtje e riparim automjeteve **1,625,110 lekë** dhe shpenzime për blerje mallrash e pagese tarifash **1,193,080 lekë**.

f. Në të gjitha AdZM-të, aktualisht njësi varësie të AKZM Tiranë, megjithëse është bërë transferimi i pronave dhe aseteve me VKM, janë përfshirë në inventarin kontabël si vlera ndërtimore, por nuk është kryer inventarizimi i tyre, veçanërisht nuk janë vlerësuar e përfshirë trojet për **57 objekte** dhe nuk janë kryer veprimet e nevojshme për regjistrimin në ZVRPP.

g. AKZM Tiranë për vitet 2016, 2017 dhe 9/mujorin 2018 zotëron strukturë të paqëndrueshme punonjësish me rreth 254 në AdZM ku kanë ndërprerë marrëdhëniet **65 punonjës** me kontratë; me nivel kualifikimi të pamjaftueshëm, ku **91 punonjës** ose 36.3 % me nivel të mesëm profesional pyjore, bujqësore, zootekni, mesme të përgjithshme, teknike strukture kjo e pa përshtatshme, jo funksionale dhe jo në përputhje me kriteret e kërkesat detyrat, funksionet përcaktuar në VKM nr.102, datë 04.02.2015, gjendje kjo për shkak të mos nxjerrjes e miratimit të aktit përkatës të kritereve të punësimit.

Opinionit i auditimit:

Nga auditimi i përputhshmërisë, mbështetur në Standardet ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI 4000, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së dhe në Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin AKZM, nuk u konstatuan devijime materiale por devijime në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilën japim opinion të pakualifikuar.

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje 1: Nga auditimi u konstatua se për rekomandimet e dërguara (në lidhje me auditimet e kryera në AdzM Qarku Shkodër) me shkresën nr.111/6 prot, datë 04.11.2016, janë marrë masat dhe janë realizuar 33 masa organizative nga 36 masa të rekomanduara, 3 masa organizative janë ende në proces, janë realizuar 2 masa shpërblim dëmi nga 4 masa gjithsej të rekomanduara dhe 2 janë realizuar pjesërisht. (*Trajtuar hollësisht në faqet 5-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 1: AKZM të marra masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për përmbushjen e rekomandimeve e 3 masave organizative dhe 2 masave shpërblim dëmi në vlerën 1,104,610 lekë.

Menjëherë

Gjetje 2: Është konstatuar se AdzM Kukës dhe Dibër kanë lidhur në **5 raste**, kontrata qiraje për dhënie në përdorim të fondit pyjor publik me subjekte të cilët do ta përdorin me qëllim ndërtimin e HEC-ve. Rezulton se vetëm në **1 rast**, fondit pyjor publik është vënë në përdorim nga qiramarrësi, i cili ka filluar punimet e HEC-it. Për 4 kontratat qiramarrësit edhe pse kanë më shumë se 1 vit që i kanë marrë me qira, nuk i kanë vënë ende në përdorim për arsye se nuk kanë

filluar punimet e HEC-ve respektive Njëherazi konstatohet se monitorimi është i ulët duke qenë se nuk kanë filluar punimet. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.81, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, Urdhrit të Ministrit të Mjedisit nr.129, datë 23.06.2016 “Për Miratimin e Procedurës së Dhënies në Përdorim me Kontratë Qiraje të Sipërfaqeve në Zonat e Mbrojtura”, VKM nr.102, datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e funksionimit e të organizimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura, i ndryshuar (Trajtuar hollësisht në faqet 20-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 2.1: AKZM në bashkërendim me AdZM Kukës e Dibër të marrë masa dhe të përmbushi detyrimet ligjore për monitorimin e mbarëvajtjes dhe përmbushjes së detyrimeve të qiramarrësve për këto kontrata sipas përcaktimeve dhe akteve ligjore e nënligjore që gjejnë zbatim në këtë veprimtari.

Brenda muajit Shkurt 2018

Gjetje 3: AKZM Tiranë për secilin prej viteve buxhetore vitet 2016, 2017 dhe 2018 nuk ka zbatuar procedurat për hartimin e PB-ve dhe PBA-ve, pasi nuk ka ngritur Grupin për Menaxhimin Strategjik (GMS ose GMSBI) të AKZM, Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP) mungojnë kalendarët e zbatuar për procedurat e ndjekura, megjithëse pretendohet se ka dërguar në formë elektronike në Ministrinë përkatëse formularët përkatës. Në PB dhe PBA-të ka parashikime jo të sakta e me rezerva në të ardhurat nga vizitorët dhe në shpenzime të nevojave për vënien nën administrim të pasurive të paluajtshme; gjendje kjo në shkelje procedurave dhe afateve 15 Mars-Qershor-Gusht, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me udhëzimin përkatës “Për Përgatitjen e Buxhetit vitit 2016,2017 dhe 2018” (Trajtuar hollësisht në faqet 8-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 3.1: AKZM Tiranë të marrë masa për zbatimin e procedurave, shoqëruar me ngritjen e strukturave përkatëse ligjore në procesin e hartimit të PB dhe PBA-ve, parashikimin e sakte të ardhurave (të ardhurat nga vizitorët dhe përdorimi i resurseve) dhe shpenzimeve me synim përgatitjen e buxheteve PB, PBA, real dhe funksional për sigurimin e përmbushjes së qëllimit, funksioneve për të cilat është krijuar nëpërmjet realizimit të objektivave.

Brenda muajit Mars 2019

Gjetje 4: AKZM Tiranë për secilin prej viteve buxhetore vitet 2016, 2017 ka pasur nivele të ulta realizimi të buxheteve (megjithëse të parashikuara me rezerva), mosrealizime të rrjedhura nga mosndjekja sistematike, raportimi mos korrektimet e mos rialokimet në kohë; përkatësisht në viti 2016, realizimi, 97%, ose në shifra absolute 493,325 mijë lekë kundrejt planit 503,774 mijë lekë, me diferencë mosrealizimi prej -9,054 mijë lekë. Këto kanë ardhur edhe si rezultat i rishpërndarjeve të herëpashershme e sidomos në fund vitin 2016; ndërsa në viti 2017 realizimi në nivelin 85 %, ose **218,862 mijë lekë** kundrejt planit **257,644 mijë lekë**, me mosrealizim prej **-38,743 mijë lekë**, ky mosrealizim krahas mangësive të tjera në hartim menaxhim është ndikuar kryesisht edhe nga shtesat apo rishpërndarjet gjatë vitit, si dhe nga parashikimet me rezerva të burimeve; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr.147/2015, datë 17.12.2015 “Për buxhetin e viti 2016”, ligjin nr.130/2016, datë 17.12.2016 “Për buxhetin e viti 2017”, ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 ”Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të Zbatimit të Buxhetit” (Trajtuar hollësisht në faqet 8-15 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 4.1: AKZM Tiranë të marrë masa për rritjen e shkallës menaxhimit, evidentimit ndjekjes dhe raportimit të buxhetit, me synim plotësimin e çdo zëri të buxhetit për sigurimin e arritjes të objektivave dhe planveprimtari të çdo viti ushtrimor.

Në vijimësi

Gjetje 5: AKZM Tiranë për vitet 2016, 2017 dhe 9/mujorin 2018, lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave dhe masat për zbatimin e ligjit nr.81/2017 datë 4.5.2017 “Për Zonat e Mbrojtura” nenit 57, nuk ka një dokument të miratuar tërësor dhe specifik për çdo ZM, si udhëzim për rregullat e përdorimit e të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe për pagimin e çmimeve për to, gjendje kjo në mos përmbushje të nenit 57 pika 4 të ligjit nr.81/2017, datë 4.5.2017 “Për Zonat e Mbrojtura” ku citohet se:”4. *Me propozim të AKZM-së, ministri miraton udhëzimin për rregullat e përdorimit e të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe për pagimin e çmimeve për to*“(Trajtuar hollësisht në faqet 15-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 5.1: AKZM Tiranë të marrë masa dhe të hartojë duke e miratuar tek Ministri “**Udhëzimin për rregullat e përdorimit e të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe për pagimin e çmimeve për to**”, me synim identifikimin, emërtimin cilësimin e burimeve të ardhurave nga aktiviteti në Zonat e mbrojtura.

Brenda muajit Mars 2019

Gjetje 6: AKZM Tiranë raporton realizimin e të ardhurave me tejkallim për vitet 2016 në masën 114%, në viti 2017 me realizim 125%, tejkallime të cilat kanë ardhur nga parashikime me rezerva për të dy vitet, ndërsa me mosrealizime përkatësisht për paraqitet me mosrealizime në viti 2017 dhe 9/mujorin 2018,; ndërsa për 9/mujorin vitin 2018, të ardhurat janë realizuar 14,835 mijë lekë kundrejt planit vjetor 17,470 mijë lekë ose 83 %, me mosrealizim -2,635 mijë lekë, ndërsa kundrejt planit 9/mujor prej 13,102 mijë lekë, ose 113%, me tejkallim +1,733 mijë lekë. Këto nivele tejkallimi në të ardhurat megjithëse aktualisht në peshe të vogël specifike, tregojnë për programime e parashikime jo reale e me rezerva mungese të vendosjes e funksionimit të Sistemit të mekanizmave eficientë të kontrollit të brendshëm dhe sidomos mungesë të kontrollit të territorit të Zonave të Mbrojtura(ZM)(Trajtuar hollësisht në faqet 15-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 6.1: AKZM Tiranë të marrë masa për rritjen e nivelit të ardhurave nëpërmjet përsosjes mënyrës së parashikimit, vendosjes së një sistemi të studiuar programimi shkencor me parashikime reale duke eliminuar parashikimet më rezerva me synim rritjen e të ardhurave nga shitja e biletave vizitoreve (vendas e turistë) si drejtim kryesor perspektiv në të ardhmen dhe të ardhurave nga përdorimi i pyjeve dhe kullotave në zonat e mbrojtura duke forcuar kontrollin e territorit të ZM si dhe duke vendosur e zbatuar sistemin e mekanizmave të kontrollit të brendshëm në administrimin e ZM-ve.

Brenda muajit Maj 2019.

Gjetje 7: AKZM Tiranë pasqyron gjendje në llogari me datë 31.10 2018 të ardhura të pa përdorura në shumën **86.735.877.93 lekë të trashëguara dhe të krijuara gjate viteve 2016,2017 dhe viti 2018**, për të cilën theksojmë se nga auditimi i masave të marra për zbatimin e ligjit nr.81/2017 datë 4.5.2017 “Për Zonat e Mbrojtura” nenit 58, rezulton se nuk u paraqit një dokument (draft VKM-je) i miratuar për “*Të ardhurat e gjeneruara nga tarifatat, masa dhe kriteret e përdorimit të tyre*”, gjendje kjo në mos përmbushje të nenit 58 pika 4 të ligjit nr.81/2017 datë 4.5.2017 “Për Zonat e Mbrojtura”, ku citohet se: “4. *Të ardhurat e gjeneruara nga tarifatat, masa dhe kriteret e përdorimit të tyre*”përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrisë”(Trajtuar hollësisht në faqet 15-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 7.1: AKZM Tiranë të marrë masa për zbatimin e procedurave dhe të hartojë e miratojë në organet përkatëse dokumentin rregullator për “*Të ardhurat e gjeneruara nga tarifatat, masa dhe kriteret e përdorimit të tyre*”, me synim çbllokimin dhe vënien në përdorim të ardhurave në vlerë **86,735,877 lekë** që janë gjendje në bankë, të trashëguara dhe krijuar në

periudhën 2016- 9 mujori 2018, duke bërë një program pune për përdorimin tyre vënien në përdorimi në investime me objekt zhvillimi emergjente mjedisore dhe në krijimin e infrastrukturës turistike për të rritur të ardhurat nga shfrytëzimi i resurseve që kanë Zonat e mbrojtura.

Brenda muajit Maj 2019.

Gjetje 8: AKZM dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit janë në proces konsultimi, hartimi, miratimi e zbatimi të procedurave të një sërë aktesh nënligjore (përmendur analitikisht më poshtë), por konstatohet vonesë e ngadalësi në këto procese në tejkalim të afateve të detyrimeve ligjore, në kundërshtim me ligjin nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, neni 71, pika 2, ku shprehet; “Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 6, të nenit 16; të pikës 5, të nenit 19; të pikës 4, të nenit 42; të pikës 1, të nenit 45 dhe të pikës 4, të nenit 57, brenda dy vjetëve nga hyrja e tij në fuqi”, përkatësisht të **5 akteve nënligjore** lidhur me detyrimet sipas:

pikës 6, të nenit 16, ku shprehet: “Me propozimin e AKZM-së, ministri miraton udhëzimin për procedurat e ndalimit të përkohshëm të veprimtarive të miratuara kur po cenohet qëllimi për të cilin është shpallur zona e mbrojtur mjedisore”,

pikës 5, të nenit 19: “Rregullat për kalimet e vizitorëve e të turistëve për afate të shkurtra kohore, me qëllim respektimin e masave mbrojtëse të përcaktuara në planin e menaxhimit, miratohen me udhëzim të ministrit, me propozimin e AKZM-së”,

pikës 4, të nenit 42: “Struktura e planit të menaxhimit, përmbajtja dhe kriteret e rishikimit të tij miratohen me udhëzim të ministrit. Planet e menaxhimit të zonës së mbrojtur mjedisore janë 10-vjeçare.”

pikës 1, të nenit 45: “Zonat e mbrojtura mjedisore regjistrohen në portalin dhe Bazën e të Dhënave Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, që hartohet dhe administrohet nga ministria. Rregullat për hartimin, përmbajtjen, administrimin, përditësimin dhe formatin e tij miratohen me udhëzim të ministrit, bazuar në ligjin nr.10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

pikës 4, të nenit 57: “Me propozim të AKZM-së, ministri miraton udhëzimin për rregullat e përdorimit e të gëzimit të shërbimeve që ofron zona e mbrojtur mjedisore dhe për pagimin e çmimeve për to.” (Trajtuar hollësisht në faqet 15-20 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 8.1: AKZM Tiranë të marrë masa për shpejtimin e plotësimin e procedurave të hartimit e miratimit të 5 akteve nënligjore si dhe udhëzimeve e rregulloreve përkatëse me synim plotësimin me aktet e duhura nën ligjore dhe përmbushjen e detyrimeve në afatin e caktuar për vënien në zbatim të ligjit nr. 81/2017, datë 4.5.2017 “Për zonat e mbrojtura”

Brenda muajit Mars 2019

Gjetje 9: AKZM Tiranë për vitet 2016, 2017 dhe 9/mujorin 2018, në strukturën organike të ndërtuar sipas përshkrimeve të vendeve të punës, nuk janë përfshirë dhe lënë jashtë përshkrime të proceseve për një vend pune me profesion specifik, të lidhur me mbulimin e menaxhimit administrimit, shërbimit mirëmbajtjes e mbajtjes në gatishmëri të mjeteve tokësore e ujore, pra dhe shpenzimeve të lidhura me një numër inventari të konsiderueshëm prej **86 mjetesh** për të cilat vihen në dispozicion shuma të konsiderueshme të buxhetit vjetor të AKZM-së, ku menaxhimi dhe administrimi i shpenzimeve të këtij parku mjetesh, duhet të menaxhohet sipas kërkesave të ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe Kontrollin” dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011”Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” (Trajtuar hollësisht në faqet 23-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 9.1: AKZM Tiranë të marrë masat e duhura për përmirësimin dhe përshtatjen e strukturës organike, e ku të përfshijë një vend pune të përshkruar me proceset e mbulimit të

menaxhimit, administrimit, shërbimit mirëmbajtjes e mbajtjes në gatishmëri të mjeteve, si dhe marrë masa për mirëadministrimin e shpenzimeve të buxhetit për mbajtjen e e gjendjes teknike dhe inventarit për 86 mjete të lëvizëse tokësore dhe ujore.

Brenda muajit Shkurt 2019

Gjetje 10: Nga AKZM Tiranë për vitet 2016, 2017 dhe 9/mujorin 2018 kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës **65 punonjës** me kontratë ndarë: 5 punonjës në viti 2016, 29 punonjës në viti 2017 dhe 31 punonjës në viti 2018. Ndërprerjet kanë qenë kryesisht me shkak dorëheqje apo dalje në pension, ndërsa në **24 raste** apo 37% e tyre përkatësisht; **8 raste** në viti 2017 dhe **16 raste** në viti 2018, ndërprerja ka qenë “**Ndërprerje me vendim largimi**“. Pra, janë ndërprerje të njëanshme nga punëdhënësi që bart riskun për dëm ekonomik nga vendimet e gjykatave, pas kalimit në proces gjyqësor sipas kërkesave të kontratave të punës nenit 121,134,153 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar. Nga auditimi rezultoi se në 3 raste përkatësisht në 2 raste nga Ish punonjës të AdZM Korçë çështja është në proces gjyqësor, ndërsa 1 rast AdZM Vlorë çështja gjyqësore i ka dhënë të drejtë punëdhënësit AKZM për ndërprerjen e marrëdhënies se punës, pasqyruar në tabelën “Lëvizja e numrit fizik dhe mesatar nga Largimet dhe emërimet e punonjësve me kontratë viti 2016,2017 dhe 2018”(Trajtuar hollësisht në faqet 23-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 10.1: AKZM Tiranë, Drejtori i përgjithshëm, sektori i burimeve njerëzore dhe juristi të marrin masa për ndjekjen e procedurave administrative dhe proceseve gjyqësore të ankimimeve eventuale të 24 punëmarrësve për ndërprerje të njëanshme të marrëdhënies dhe kontratës së punës nga punëdhënësi AKZM “**Me vendim largimi**”, përkatësisht për 8 punonjës në vitin 2017 dhe 16 punonjës në vitin 2018, pasqyruar në pasqyrën “Lëvizja e numrit fizik dhe mesatar nga largimet dhe emërimet e punonjësve me kontratë viti 2016,2017 dhe 2018”.

Në vijimësi

Gjetje 11: Nga AKZM Tiranë emërimet dhe pranimet në punë kërkohet bëhen në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 i ndryshuar “Kodi i punës”, ndërsa në VKM nr. 102, datë 04.02.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura” në kreu V, pika 2, “Procedura e rekrutimit” përcaktohen se: “Marrëdhëniet e punës së punonjësve të administratave të zonave të mbrojtura rregullohen sipas Kodit të Punës”; ndërsa pika 3 shpreh: “Kriteret dhe përshkrimi i vendeve të punës për punonjësit e administratave të zonave të mbrojtura miratohen nga Ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura , me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm”.

Gjatë auditimit nuk u paraqit ndonjë dokument për Kriteret dhe përshkrimi i vendeve të punës për punonjësit e administratave të zonave të mbrojtura, i miratuar nga Ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura, por as në rregulloren e AKZM “Rregullorja e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe e Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura“, miratuar me urdhrin nr.72/1, datë 15.06.2015 të Ministrit Mjedisit në të cilën përshkruhen detyrat për çdo vend pune, nuk përmenden kriteret për punësimin në AdZM (Trajtuar hollësisht në faqet 23-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 11.1: AKZM Tiranë Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa dhe të përgatisë dhe të paraqesë për miratim tek Ministri dokumentin “Kriteret dhe përshkrimi i vendeve të punës për punonjësit e administratave të zonave të mbrojtura (AdZM)”, kjo sipas kompetencave e në referim të VKM nr. 102, datë 04.02.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura” kreu V, pika 3, “Procedura e Rekrutimit” sipas përcaktimit “Kriteret dhe përshkrimi i vendeve të punës për punonjësit e administratave të zonave të mbrojtura miratohen nga Ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm”

Brenda muajit Mars 2019

Gjetje 12: AKZM Tiranë në vitin 2018 (por edhe në vitin 2016 e 2017) paraqitet një strukturë faktike të punësuarish me kontrata në AdZM-të rajonale me përbërje me arsim të lartë inxhinieri pyjesh e druri brenda profesionit **87 punonjës** ose 34,7%, ndërsa me arsim të lartë **jashë profesionit: 24 punonjës**, ose 9,6%, me specialitet teknologji ushqimore, zootekni-veterinari, agro-biznes, bioteknologji, jurist; **13 punonjës** ose 5,2% me zooveterineri, bioteknologji agromjedis; **21 punonjës** ose 8,4% me specialitet menaxhim biznes, ekonomi, financë, administrim publik, politika agrare; **12 punonjës** ose 4,8%, me specialitet mësues biologji-biokimi, cikli ulet letërsi, edukim fizik e piktor; **3 punonjës** inxhinier mekanik, ndërtimi e kimist, kurse **91 punonjës** ose 36,3% me nivel të mesëm profesional si; shkollë mesme pyjore, bujqësore, zootekni, mesme të përgjithshme, teknike dhe **2 punonjës** me shkollë 8 vjeçare të ulet profesionale. Kjo strukturë është e pa përshtatshme, jo funksionale dhe jo në përputhje me kriteret e kërkesat, detyrat dhe funksionet e përcaktuara në VKM nr.102, datë 04.02.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura”, pasqyruar në tabelën emërtuar “Grupimi i punonjësve sipas profesioneve dhe arsimit për vitet 2016, 2017 dhe 2018 në AKZM Tirane dhe AdZM-të e Qarqeve” (Trajtuar hollësisht në faqet 23-30 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 12.1: AKZM Tiranë të marrë masa e të nisë procedurat për rishqyrtimin e rekrutimeve të bëra dhe të përshtatë marrëdhëniet kontraktore të punësimit të punonjësve me kontratë, të hartojë rishqyrtoje miratoje tek ministri dhe zbatojë kriteret përkatës (nëse ato mungojnë apo nuk përshtaten të hartohen rishkruhen e kërkohet miratimi i ministrit).

Brenda maujit Mars 2019

Gjetje 13: AKZM Tiranë për periudhën 2015, 2016, 2017 dhe 9/mujorin e vitit 2018, ka mangësi në rregullshmërinë e mbajtjes së dokumentacionit librave kontabël ditarëve të bankës e të arkës, kështu në mbajtjen e ditarit të Bankës u konstatuan në **66 raste-numra** parregullsi e mangësi në identifikimin dhe regjistrimin e urdhër shpenzimeve dhe konkretisht: anulime të urdhër shpenzimeve për **22 raste-numra** përkatësisht: viti 2016 në 5 raste, viti 2017 në 7 raste dhe viti 2018 në **10 raste**; parregullsi lidhur me përsëritjen e numrave rendor për 12 raste përkatësisht në viti 2015 në 5 raste, viti 2018 në 7 raste; përdorim numra me fraksion në 8 raste ndarë: 3 raste viti 2016, viti 2017 në 5 raste; kapërcime numrash rendor 24 raste ndarë: në viti 2016 në 18 raste, viti 2017 në 4 raste dhe viti 2018 në 2 raste; parregullsi që vijnë në kundërshtim me Kreun e I neni 3 pika 8 germa “c”, Kreu II, neni 6, pika 2 të ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar’.

Nga auditimi i këtyre rasteve të parregullsive në mbajtjen e ditarit të bankës viti 2016,2017 dhe 9/mujorin 2018 të lidhura me përsëritjes së numrave, ngatërrimit të rendit kronologjik, përdorimit të numrave me fraksion rezultoi se urdhër shpenzimet megjithëse mbajnë të njëjtin numër, datë dhe megjithëse ato paraqesin dhe individualizojnë ngjarje dhe kryerje shpenzimesh reale të veçanta, individualisht të përcaktuara me shifra vlerore të ndryshme por rezervohemi në të drejtën e dhënies së opinionit që ato nuk pasojnë efekte të mos korrespondimit (përputhshmërisë) të shumave në ditarin e bankës mujor dhe vjetor, në kundërshtim me Standardet e Kontabilitetit dhe dispozitat e tjera ligjore të kontabilitetit dhe Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” (Trajtuar hollësisht në faqet 30-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2. Nga AKZM Tiranë janë kryer shpenzime me dokumente justifikuese me mangësi e jo të plota si në procedurat e marrjes në dorëzim të mallrave e shërbimeve, në ndjekjen e shpenzimeve në tërësi por në administrimin e shpenzimeve të transportit, mirëmbajtjen e riparimit e automjeteve të cilat përfshijnë një inventar të konsiderueshëm prej rreth 84 automjete motorra dhe mjete lundruese. Kështu për vitin 2016-9/mujorin 2018 nga auditimi me zgjedhje janë kryer shpenzime me dokumente justifikuese me mangësi e jo të plota si në procedurat e marrjes në dorëzim të

mallrave e shërbimeve ashtu dhe në ndjekjen e shpenzimeve blerje mallrash me mosndjekje e zbatim të specifikimeve teknike në vlerën totale **2,818,923 lekë**, nga të cilat: për mirëmbajtje e riparim automjetesh **1,625,110 lekë** dhe shpenzime për blerje mallrash e pagese tarifash **1,193,080 lekë**.

Kryerja e këtyre shpenzimeve me dokumentacion jo të plotë justifikues dhe mangësi në marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve vjen në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me UMF nr.30, datë 29.12.2010 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” mangësi e mosveprime që ka sjellë si pasojë mos justifikimin me dokumente të plota të kryerjes së shpenzimit, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (*Trajtuar hollësisht në faqet 30-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

Rekomandim 13.1: AKZM Tiranë, Drejtori i përgjithshëm të marrë masa të analizojë e nxjerrë përgjegjësinë për mos justifikimin me dokumente të plota të kryerjes dhe likuidimit të shpenzimeve në vlerën totale prej **2,818,923 lekë**, nga të cilat: për mirëmbajtje e riparim automjetesh **1,625,110 lekë** dhe shpenzime për blerje mallrash e pagese tarifash **1,193,080 lekë**, në periudhën viti 2016,2017 dhe 9/mujorin 2018.

Brenda muajit Shkurt 2019

Rekomandim 13.2: AKZM Tiranë të marrë masa për të siguruar dhe arkivuar në arkivën e institucionit dokumentet e policës sigurimit(origjinalet për ato që kanë përfunduar dhe fotokopje për periudhën në vijim) për 57 mjete të siguruar sipas pagesave në vlerën totale **355,961 lekë** për siguracion të 26 mjeteve sipas e urdhër shpenzimet nr.138, datë 24.07.2018 me vlerën **113,762 lekë** për Siguracion 11 mjete, U.Shp nr.198, datë 14.09.2018 vlerë 18,380 lekë siguracion 1 mjet, U.Shp nr. 209, datë 26.09.2018 vlerën **223,819 lekë** për Siguracion 14 automjete; si dhe dokumentacionin për 21 mjete sipas urdhër prokurimit nr.164, datë 03.05.2018, për siguracion të 57 mjeteve dhe motorcikleta me fond limit 750,000 lekë pa tvsh në ftesa për ofertë nr.545/1, datë 03.05.2018, po për 57mjete me fond limit 750,000 lekë pa tvsh, si dhe oferta fituese datë 12.06.2018 e subjektit “xy SHA; kjo jo vetëm për justifikimin e pagesës së shpenzimit por veçanërisht për menaxhimin e procesit dhe ndjekjen e realizimit të ofertës së pranuar, si dhe për pasjen e kopjes policës sigurimit për çdo rast eventual të humbjes.

Brenda muajit Janar 2019

Gjetje 14: AKZM Tiranë në periudhën 2015, 2016, 2017 deri 9/mujorin 2018 është furnizuar dhe ka trashëguar gjendje naftë që luhetet nga 1,2 deri 1,5 herë të sasisë së përdorimit vjetor, pra krijuar rezerve për **1-deri 1,5 vite**, ndërsa rezervat në benzinë luhaten nga 1,5;1,7; 2,2 deri 2,9 herë ose mbi nevojat për **1,5 deri 3 vjet**, gjendje kjo që tregon krijim rezerve të panevojshme, bllokim dhe keqpërdorim të fondeve të buxhetit për shpenzime operative, si dhe që bart risk të mëvonshëm abuzimi, pasi blerja bëhet elektronike duke mbetur kështu stoku (magazinimi) i karburantit tek shitësi për disa vjet. Këto veprime e mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjin nr.147/2015, datë 07.11.2015, nr.130/2016, datë 15.12.2016, nr.109/2017, datë 30.11.2017 “Për buxhetin e vitit 2018”, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, pasqyruar në tabelën emërtuar “**Bilanci i gjendjes dhe lëvizjes së karburanteve nga Inventari i magazinës sipas viteve**”(Trajtuar hollësisht në faqet 52-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandim 14.1: AKZM Tiranë të marrë masat për uljen e gjendjes së rezervave të krijuar në nivelin e nevojave të konsumit për 1-3 vjet, duke mos parashikuar fonde, për blerje karburanti, mos lidhur kontratë vjetore për blerje karburanti deri në konsumin e stokut të paguar e mbetur

gjendje tek shitësi, pasqyruar në tabelën emërtuar “*Bilanci i gjendjes dhe lëvizjes së karburanteve nga Inventari i magazinës sipas viteve*”.

Menjëherë.

Rekomandim 14.2: AKZM Tiranë të kryejë aktrakordim me nënshkrime të ndërsjella për detyrimet e sasisë dhe vlerës së karburanteve benzinë e naftë të likuiduara dhe të pa tërhequra, pra të sasisë mbetur stok tek shitësi gjendje me 31 Dhjetor për secilin prej viteve 2015, 2016, 2017 dhe 31.12.2018.

Brenda muajit Janar 2019

Gjetje 15: Nga auditimi i dokumentacionit, procesverbaleve të komisioneve të caktimit të normativave të konsumit të karburanteve dhe “Listës Mjeteve tokësore ujore detare sipas Qarqeve“, konstatojmë se procesverbalet për mjetet autovetura janë me mangësi, pasaktësi në formë e në përmbajtje, janë të pa argumentuar, janë selektive nga pikëpamja e strukturës së kategorisë rrugëve mbi të cilat ato janë vendosur që nuk japin garanci në vërtetësinë, saktësinë në përputhje me realitetin; ndërsa mungojnë caktimi i normativave për mbi 40 motoçikleta.

Këto normativa referuar procesverbaleve të mbajtura nuk janë bazuar në analizën e mbështetur në pasaportat teknike të mjetit sipas katalogut, ndërkohë që në strukturën e paraqitur pesha kryesore janë mjete të reja. Gjithashtu procesverbalet e komisioneve të matjes së normativave të karburantit shpesh herë nuk kanë identifikuar të dhënat sipas pasaportës teknike për mjet që janë mbajtur. Në përbërjen e anëtarëve të komisionit nuk ka specialist të fushës si dhe nuk paraqiten në shumicën e rasteve rrugët e përshkruara sipas kategorive si dhe konsumin e karburantit për çdo kategori. Në disa raste për normativa janë përdorur vërtetime apo marrëveshje të mëparshme të pa provuara që nuk janë në formën dhe përmbajtjen e dokumentit për normativë. Disa normativa nuk janë koherente apo janë të vjetërsuara, kjo sepse mjetet e transferuar pasqyrohen në listën e inventarit me vitin e marrjes dhe jo me vitin e vënies në shfrytëzim; gjendje kjo që sjell si pasojë keqmenaxhim të shpenzimeve të karburanteve në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”(Trajtuar hollësisht në faqet 52-59 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 15.1:AKZM Tiranë të marrë masat, të ngrejë grup pune me specialistë të fushës inxhinierisë mekanike e transporti për rishqyrtimin, normimin dhe vendosjen e normativave të konsumit të karburanteve për 86 mjete, automjete dhe mjetet ujore, si dhe përfshirjen në caktimin e normativave të mjeteve motoçikleta. Caktimi i normativave të bëhet nga komisione kompetente dhe profesionale, duke hartuar dokumentacionin përkatës të argumentuar dhe marrë në konsideratë të dhënat teknike sipas pasaportës së automjetit.

Brenda muajit Shkurt 2019

Rekomandim 15.2:AKZM Tiranë të marrë masa me grup pune teknike për vendosjen, caktimin e normativave të harxhimit të shpenzimeve për të vendosur normivat për shërbimet e riparimet si tregues për parashikimin e nevojave për buxhet por edhe nevoja të programimit e grafikimit të kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes të inventarit prej 86 mjeteve motorike tokësore e ujore.

Brenda muajit Shkurt 2019

Gjetje 16: Në AKZM Tiranë, nga auditimi lidhur me inventarizimin dhe regjistrimin e pasurive të paluajtshme, rezulton:

1. AKZM nuk ka krijuar, çelur librin e inventarit analitik të AQT-ve sipas llojeve për vitin 2016 dhe vitin 2017 me emërtimet dhe karakteristikat përkatëse, i grupuar si dokument themelor mbi të cilin mbështetet evidenca kontabile por edhe menaxhimi i fondeve në funksion të përmbushjes së qëllimit funksioneve dhe detyrave të AKZM dhe AdZM në 12 Qarqe, në kundërshtim me Kreun IV “Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, Inventarizimi i aktiveve”

neni 73, neni 85, germa “a”, “b”, “c” të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” (Trajtuar hollësisht në faqet 61-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Nuk është kryer regjistrimi i **58 pasurive** të llojit ndërtesa e objekte ndërtimore, të regjistruara si vlera në kontabilitet, ne pronësi, administrim dhe juridiksion të AKZM dhe AdZM-ve, nuk janë parashikuar në buxhetin përkatës të nevojshme për shpenzime për tarifën e regjistrimit dhe përgatitje dokumentacioni të regjistrimit në ZVRPP Tiranë dhe ZVRPP-të përkatëse të rretheve, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr.33/2012, datë 21.3.2012 “Për regjistrimin e pasurive të Paluajtshme”, për:

a. 17 objekte ndërtesa zyra të AdZM-ve (me anekse të tyre),

b. 41 objekte ndërtesa me funksion si stacione, ndërtesa, qendra vizituesh, stacione pyjor etj., të përfshira si vlera në inventarët Kontabël (Trajtuar hollësisht në faqet 72-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 16.1: AKZM Tiranë të marrë masat për përfshijë në buxhet fondin për shpenzimet e përgatitjes dokumentacionit dhe pagesën e tarifës regjistrimit si dhe të kryejë regjistrimin e **58 pasurive** të llojit ndërtesa e objekte ndërtimore, të regjistruara si vlera në kontabilitet, ne pronësi, administrim dhe juridiksion të AKZM dhe AdZM-ve, prej tyre: **17 objekte ndërtesa zyra** të AdZM-ve (me anekse të tyre) dhe **41 objekte ndërtesa me funksion si stacione, ndërtesa, qendra vizituesh, stacione pyjor etj.**, si dhe të çelë librin e inventarit analitik të AQT-ve sipas llojeve me emërtimet dhe karakteristikat përkatëse, të grupuar si dokument themelor mbi të cilin mbështetet evidenca kontabile por edhe menaxhimi i fondeve të AKZM dhe AdZM-ve.

Brenda 6 mujorit të I të vitit 2019

Gjetje 17: AKZM Tiranë ka mangësi në plotësimin e pasqyrave financiare për viti 2016 dhe viti 2017 dhe të relacionit përkatës shoqërues:

1. Ka mangësi në plotësimin e formularëve të bilancit dhe i anekseve përkatëse të formularit nr.1, mos pasqyrim në llogarinë 210, të vlerës toka trojeve, terreneve që u përkasin llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione, mospasqyrim e mos kontabilizim në klasën IV të “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët”, në llogarinë 468 të vlerës debitorë të pashlyera të qerasë objekteve, me kontrata me afat shtrirje kohore mbi 10 vjet, që janë dhe objekt regjistrimi në ZVRPP. Këto mangësi përveç sa sipër janë me ndikime në dhënien e opinionit të audituesit, Veprime në kundërshtim me nenin 20 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008”Për menaxhimin në sistemin buxhetor në RSH”, ku nëpunësi zbatues është përgjegjës për hartimin e pasqyrave financiare sipas formularëve standard dhe afateve të përcaktuar nga MF, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.12.2006 “Për Përgatitjen dhe Raportimin e Llogarive Vjetore të vitit 2006, për Institucionet Qendrore, Organet e Pushtetit Vendor dhe Njësive të Menaxhim-Zbatimit të Projekteve e Marrëveshjeve me Donatorë të Huaj”, të ndryshuar me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.26, datë 27.12.2007 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.14, datë 28.12.2006”

2. Relacioni shpjegues i pasqyrave financiare është i cekët dhe i kufizuar, në ndonjë rast edhe jo real, pasi nuk jepen sqarime për formatin 3/2, ku mungon e nuk sqarohen e analizohen të ardhurat e veta sipas burimeve nga vizitorët dhe nga qiradhëniet apo nga burime të tjera, nivelet e parashikimit dhe të realizimit shkaqet dhe risqet faktorët nxitës e frenues, por ato trajtohen e paraqiten në mënyrë globale, mungojnë sqarimet për formatin nr.6 “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve të qëndrueshme vlera bruto”, si dhe ka pasaktësi në relacionin për stokun e krijuar në rezervat e karburanteve (Trajtuar hollësisht në faqet 63-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 17.1: AKZM Tiranë të marrë masat për kryerjen e kontabilizimeve dhe pasqyrimin e plotësimin me saktësi të formateve të bilancit vjetor 2018 në të cilin të pasqyrojë e përfshijë rregullimet për mangësitë lidhur me pasqyrimin formularin nr.1 në llogarinë 210 të vlerës toka trojeve, terreneve që u përkasin llogarisë 212 “Ndërtime e konstruksione, pasqyrimin

e kontabilizim në klasën IV të “Kërkesa arkëtimi mbi debitorët”, në llogarinë 468 të vlerës debitorë të pashlyera të qerasë objekteve, me kontrata me afat shtrirje kohore mbi 10 vjet, që janë dhe objekt regjistrimi në ZVRPP të konstatuara si mangësi në formatet e bilanceve të veprimtarive ushtrimore të viti 2016 dhe viti 2017.

Brenda muajit Mars 2019

Gjetje 18: AKZM Tiranë, në pasqyrat financiare dhe në evidencën kontabile të veprimtarisë të viti 2016 dhe viti 2017, nuk ka pasqyruar **detyrimet debitorë (shitesë)** të pashlyera në vlerën prej 3,997,175 lekë përkatësisht: vlera prej 1,576,443 lekë për vitin 2016 dhe vlera 2,420,732 lekë pashlyer në vitin 2017, që përbejnë detyrimet debitorë nga qiramarrësit sipas kontratave të qiradhënies të aseteve të AKZM me afat shtrirje kohore mbi 10 vjet, mosveprim në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 24.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me UMF nr.26, datë 27.12.2007 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.12.2006”(Trajtuar hollësisht në faqet 63-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 18: AKZM Tiranë të marrë masat për kryerjen e kontabilizimeve, pasqyrimin dhe plotësimin me saktësi të formateve të bilancit vjetor 2018 të **detyrimeve debitorë (shitesë)** të pashlyera në vlerën prej 3,997,175 lekë përkatësisht: 1,576,443 lekë të vitit 2016 dhe vlera 2,420,732 lekë pashlyer në vitin 2017, si dhe të listohen e ndiqen në dinamikë detyrimet debitorë nga qiramarrësit sipas kontratave të qiradhënies të aseteve të AKZM me afat shtrirje kohore mbi 10 vjet.

Brenda muajit Mars 2019 e vijimësi

Gjetje 19: AKZM nuk ka një inventar ose data-baze të gjithë florës dhe faunës në territorin e zonave të mbrojtura, në kundërshtim me pikën 4/d, neni 38, ligji nr. 81/2017, “për Zonat e Mbrojtura”. Për ato zona që kanë Plan Menaxhimi, në të mund të gjenden bimët kryesore të zonës përkatëse dhe kafshët e shpendët. Mirëpo për florën dhe faunën nuk ka një inventar të mirëfilltë si për çdo zonë dhe në total për të gjitha zonat. AKZM nuk ka një databazë të florës dhe faunës nëpër të gjithë territorin e ZM-ve të Shqipërisë. (Trajtuar hollësisht në faqet 119-124,125-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 19.1: AKZM të krijojë data-baze për florën e faunën për çdo zonë të mbrojtur më vete dhe në total për të gjitha zonat e mbrojtura në territorin e Shqipërisë.

Brenda muajit Mars 2019

Gjetje 20: Ndjekja e zbatimit të Planeve të Menaxhimit për ato ZM që e kanë një të tillë, nuk është e qartësuar apo rregulluar me rregullore, mënyra se si monitoron AKZM. Planet e menaxhimit të hartuara me qëllimin e ruajtjes dhe përmirësimit të gjendjes së një ZM-je nuk ndiqen nga AdZM-të përkatëse dhe AKZM, e cila nuk ka asnjë bazë të dhënash në drejtim të ndjekjes e zbatimit të këtyre PM-ve, duke mos zbatuar kështu nenin 43 të ligjit nr.81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”. Rrjedhimisht PM-të janë hartuar vetëm për të përmbushur detyrimin ligjor sipas pikës më sipër, por nuk kanë vlerë reale në ruajtjen, menaxhimin e gjendjes së zonave të mbrojtura (Trajtuar hollësisht në faqet 119-124,125-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 20.1: AKZM të krijojë një regjistër me të dhënat e nevojshme për ndjekjen e situatës dhe zbatimit të planit të menaxhimit për çdo zonë. Regjistri të unifikohet dhe të ketë të njëjtin format për të gjitha zonat dhe të plotësohet me informacion nga AdZM-të përkatëse nën mbikqyrjen e AKZM-së.

Brenda 6-mujorin e I të vitit 2019

Gjetje 21: AKZM nuk ka krijuar një bazë të dhënash në bazë të vlerësimeve periodike që kryhen në ZM-të nga AdZM-të dhe vetë AKZM-ja, në kundërshtim me pikën 4/d, neni 38 i ligjit nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” (Trajtuar hollësisht në faqet 119-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 21.1: AKZM të kryejë analiza periodike për problemet bazë të zonave të mbrojtura dhe të krijojë një bazë të dhënash në bazë të vlerësimeve periodike që kryhen në ZM-të nga AdZM-të dhe vetë AKZM.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Gjetje 22: AKZM nuk ka krijuar një metodologji për hartimin e planeve të menaxhimit në zonat e mbrojtura dhe aktualisht numri i PM-ve për çdo zonë është akoma i ulët, në kundërshtim me pikën 4/e, neni 38 i ligjit nr. 81/2017 (*Trajtuar hollësisht në faqet 119-124, 125-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 22.1: AKZM të krijojë metodologjinë për hartimin e planeve të menaxhimit në zonat e mbrojtura, gjë që do thjeshtësojë hartimin e PM-ve dhe për ato zona të cilat nuk e kanë një të tillë.

6-mujorin e parë të vitit 2019

Gjetje 23 : Në AKZM nuk u gjet një plan vjetor i hartuar në lidhje me kontrollet që ushtrohen gjatë vitit për asnjë nga vitet objekt kontrolli. Bazat e të dhënave në AKZM janë akoma në proces krijimi dhe nuk janë të organizuara si duhet. Rrjedhimisht nuk ka plane vjetore, si dhe kontrollet për monitorime shtrihen në çështjet që dalin gjatë proceseve të punës, pa qenë të strukturuar sipas rëndësisë dhe periudhave të vitit, kjo lidhur me jetën e egër të florës e faunës në zona, e cila ndryshon si nga zona në zonë dhe nga një periudhë e vitit në tjetrën (*Trajtuar hollësisht në faqet 119-124, 125-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 23.1: AKZM të hartojë plane vjetore për kontrollet që do të ushtrojnë gjatë vitit, në mënyrë që kontrollet të jenë të strukturuar sipas rëndësisë dhe periudhave të vitit, kjo lidhur me jetën e egër të florës e faunës në zona, e cila ndryshon si nga zona në zonë dhe nga një periudhë e vitit në tjetrën.

Vijimësi

Gjetje 24: AKZM nuk e ka ndjekur si dhe sa duhet çështjen “Kilic Aquaculture” SHPK, duke qenë se nuk mund të pretendohet se një subjekt nëse nuk prek tokë atëherë nuk është në zonë të mbrojtur dhe nuk ka nevojë të monitorohet (*Trajtuar hollësisht në faqet 119-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 24.1: Pavarësisht se në bazë të koodinatave (sipas informacionit nga AdZM Vlorë, pasi grupi i KLSH nuk ka të dhëna në lidhje me koordinatat) subjekti “Kilic Aquaculture” SHPK nuk e zhvillon aktivitetin brenda koodinatave të zonës së mbrojtur, AKZM të marrë masa dhe të ndjekë situatën nga afër, duke siguruar të gjithë informacionin e nevojshëm deri në marrjen e të gjitha të dhënave për subjektin nga AKM dhe krijimin bindjes së plotë jo vetëm që aktiviteti nuk ndodhet fizikisht në zonë të mbrojtur, por dhe që ushtrimi i aktivitetit nga subjekti të mos ketë ndikim aktual apo në të ardhmen në zonën e mbrojtur.

Brenda muajit Shkurt 2019

Gjetje 25: Nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me subjektet të cilat ushtrojnë veprimtari në zonat e mbrojtura, të cilët të vetëmonitorojnë aktivitetin që ushtrojnë, sipas kërkesave të specifikuara nga AKZM-ja në zbatim të programit të secilës zonë dhe t’ia njoftojnë këto AdZM-së përkatëse, gjë e cila është në kundërshtim me pikën 2, neni 60 i ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura” (*Trajtuar hollësisht në faqet 119-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 25.1: AKZM dhe AdZM-të rajonale bazuar në pikën 2, neni 60 i ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura” t’i kërkojnë subjekteve të cilat ushtrojnë veprimtari në zonat e mbrojtura, të vetëmonitorojnë aktivitetin që ushtrojnë, sipas kërkesave të specifikuara nga AKZM-ja në zbatim të programit të secilës zonë dhe t’ia njoftojnë këto AdZM-së përkatëse.

Në vijimësi

Gjetje 26 : AKZM nuk ka nxjerrë të dhëna periodike mbi monitorimin vjetor të zbatimit të PM të zonave dhe publikimin e të dhënave periodike vjetore në faqen zyrtare elektronike të saj, në kundërshtim me pikën 3, neni 60 i ligjit nr.81/2017(*Trajtuar hollësisht në faqet 119-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 26.1: AKZM të nxjerrë të dhëna periodike mbi monitorimin vjetor të zbatimit të PM të zonave dhe të bëjë publikimin e të dhënave periodike vjetore në faqen zyrtare elektronike të saj, sipas pikës 3, neni 60 i ligjit nr. 81/2017.

Në vijimësi

Gjetje 27: Bazuar në pikën 4 neni 60 i ligjit nr.81/2017, Plani i monitorimit dhe i vetëmonitorimit të zonave të mbrojtura është pjesë e monitorimit të gjendjes së mjedisit dhe është pjesë e rrjetit kombëtar të monitorimit të gjendjes së mjedisit, sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit duhej që AKZM të hartonte sipas afatit ligjor(*Trajtuar hollësisht në faqet 119-129 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 27.1: AKZM të hartojë planin e monitorimit dhe vetëmonitorimit të zonave të mbrojtura që është pjesë e monitorimit të gjendjes së mjedisit dhe është pjesë e rrjetit kombëtar të monitorimit të gjendjes së mjedisit, sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

6-mujorin e parë të vitit 2019

Gjetje 28:AKZM ka mungesë bashkëpunimi me njësitë e qeverisjes vendore, duke patur parasysh se ato janë pjesë e strukturave të menaxhimit të zonave të mbrojtura, në bazë të Kreut IV, neni 40 i Ligjit nr.81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” (*Trajtuar hollësisht në faqet 133-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 28.1:AKZM dhe AdZM-të të marrin masa që brenda kuadrit ligjor dhe reciprocitetit institucional të kryejnë bashkëpunime me njësitë e qeverisjes vendore, me qëllimin

Vazhdimisht

Gjetje 29: Të dhëna për bashkëpunimin me AKM janë shumë të pakta. Bashkëpunimi me AKM lidhet vetëm me rastet kur kjo e fundit kërkon mendimin e AKZM-së në raste të subjekteve të cilat dyshohen se mund të gjenden apo kërkojnë të ushtrojnë aktivitetin e tyre brenda zonave të mbrojtura(*Trajtuar hollësisht në faqet 133-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 29.1: AKZM të krijojë sa më shumë mundësi bashkëpunimi me AKM, në mënyrë që të ketë informacion në kohë reale për çdo mundësi kërcënimi të aktiviteteve të mundshme në zona të mbrojtura dhe të ketë mundësi të ndërhyjë në kohë.

Vazhdimisht

Gjetje 30: Nuk ka të dhëna për bashkëpunime sidomos përsa i përket zonave ujore, të cilat gjenden në sipërfaqet e zonave të mbrojtura. Nuk ka të dhëna për bashkëpunime me Drejtoritë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës apo inspektoratet përkatëse nëpër rrethe(*Trajtuar hollësisht në faqet 133-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 30: AKZM dhe AdZM-të krijojnë sa më shumë mundësi bashkëpunimi me Drejtoritë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës apo inspektoratet përkatëse nëpër rrethe, të cilat shërbejnë për të mbajtur nën kontroll peshkimin e pakontrolluar, duke përmendur në mënyrë të vecantë Zonën e Mbrojtur Detare Karaburun - Sazan, bazuar kjo dhe në nenin 34 të Ligjit nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”.

Vazhdimisht

Gjetje 31: Nga shqyrtimi i 7 marrëveshjeve me financime të huaja & donacione të lidhuraprej viteve 2000 para periudhës së auditimit 2015-1.09.2018, shqyrtuam qëllimin e masën e realizimit të tyre për ato projekte që mundëm të siguronim në gjuhën anglisht pranë AKZM. U konstatua se vetëm në 4 prej tyre, ka klauzola për auditimin e projektit me auditues të jashtëm. Konstatuam se nuk u janë dorëzuar e vënë në dispozicion zyrtarisht të gjitha projektet edhe pse AKZM nuk është palë në projektet, në lidhje me posedimin e projekteve, ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të tyre në lidhje me AKZM dhe ZM. Këto projekte janë:

a.Marrëveshja mes KFË & Ministria e Mjedisit (*KFË & Ministry of Environment*) në periudhën

21.12.2006 - 21.12.2011 prej 3,55 milion euro realizuar me VKM 1678 datë 24.12.2008.

b. Marrëveshja Këshilli Evropian & Ambasada italiane nr. 214/355174, datë 24.02.2015-2019;

c. Marrëveshja Banka Botërore dhe Ministria e Financave (*International Bank for Reconstruction and Development & Republic of Albania*), dt.25.07.2014-2019;

d. Projekti “Ruajtja dhe Përdorimi i Biodiversitetit në zonat rurale në Shqipëri” me donator Qeverinë Gjermane, GIZ dhe përfitues MTM, në vlerë 2,5 milion Euro, realizuar në qershor 2015-dhjetor 2018;

e. Marrëveshja mes IUCN dhe Ministria e jashtme italiane, në periudhën para krijimit të AKZM, 02.12.2009 – 02.12.2011, qëllimi i projektit ka qenë “Fuqizimi dhe Zhvillimi i kapaciteteve institucionale për planifikimin dhe menaxhimin sistematik të Zonave të Mbrojtura” për Parkun Kombëtar Shebenik - Jabllanicë dhe Peizazhit të Mbrojtur të Lumit Buna’.

Nga të gjitha këto projekte, projekti (C) i listuar realizohet me borxh ndaj qeverisë shqiptare. Për projektet (b) dhe (d) që janë donacione, stafi i AKZM nuk na paraqiti dokumenta që të kishte bërë përpjekje për t’i monitoruar këto tre projekte sa dhe si duhet. Edhe projekti (a) që ishte planifikuar të mbaronte në vitin 2011, ka mbaruar në muajin dhjetor 2015, ose gati 10 muaj pas fillimit të aktivitetit ligjor të AKZM-së dhe stafi i drejtorisë qendrore kishin shumë pak informacion dhe ishin të pa azhornuar me zbatimin e këtyre projekteve (*Trajtuar hollësisht në faqet 110-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 31.1: Sektori i projekteve dhe stafi drejtues i AKZM të marrin masa për të ndjekur projektet në zbatim të gërmës (a), (b), (c) dhe (d), lidhur me evidentimin, dokumentimin e marrjen e përfitimeve në ZM nga zbatimi i tyre, pavarësisht se projekti (b) dhe (d) janë me donacione. Ndërsa për (c), AKZM në bashkëpunim me MTM të marrë masa për të ndjekur, dokumentuar e monitoruar me imtësi fishat dhe çdo detaj që ka të bëjë me AKZM dhe ZM pasi ky projekt është me hua të cilën do ta paguajë shteti shqiptar dhe ndjekja e tij është detyrim i AKZM për pjesën që i takon asaj për ZM duke mos u justifikuar se me këto merret vetëm MM. Gjithashtu, stafi drejtues i AKZM, krijuar në shkurt 2015 ka pasur dhe ka detyrimin të marrë masa për të disponuar, arshivuar, të printuar ose online, edhe 3 projektet e tjera të hershme, nga 7 projektet gjithsej me synim njohjen me historinë dhe dokumentimin e tyre lidhur me efektet që ato kanë pasur ndaj ZM, pavarësisht se këto projekte janë realizuar para krijimit të AKZM.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Gjetje 32: Në lidhje me aktivitetin në Liqeni i Seferanit dhe Liqeni i Degës në bashkinë Belsh, të dyja Monument Natyre (MN) të shpallura me VKM nr.676 datë 20.12.2002, ku ushtrojnë me leje nga Ministria e Bujqësisë aktivitet peshkimi përkatësisht dy subjektet “Z” dhe “@”, nga shkresa me nr.1202 datë 09.10.2018 nga ana e AKZM drejtuar sekretarit të Përgjithshëm i MTM kërkohet ndërhyrje me Ministrinë e Bujqësisë për ndërprerjen e aktivitetit të peshkimit pasi nga ky aktivitet është prishur ekosistemi me ndërhyrje edhe me inerte të hedhura brenda liqeneve. Ky problem ishte konstatuar më parë, qysh më 03.09.2015 me një shkresë nr.37 prot datë 03.09.2013 nga ana e AdZM Elbasan dhe ish-drejtori i saj F. B. dhe përveç kësaj ka pasur edhe një proces-verbal në terren nga një grup prej 3 personash të AdZM Elbasan dhe dy punonjës të P/ISHMP Elbasan në datën 02.02.2016 dhe me shkresën nr.64 prot, dt.13.04.2016 ku drejtori i AdZM Elbasan i drejtohet AKZM me një propozim të çuditshëm për të hequr dy liqenet në fjalë, atë të Seferanit dhe Liqenin e Digës si ZM. Gjithashtu, bazuar tek ligji nr. 81/2017, neni 54 Bazuar tek neni 54 pika 1 mund të ishin ndërmarrë nisma të tjera ligjore nga ana e AKZM për të ruajtur këto dy liqene.

Në dosje nuk ka të dhëna për ndërmarrje të masave të tjera nga ana e AKZM midis datave 13.4.2016 dhe dt. 9.10.2018, pra për një periudhë prej gati 2,5 vjet duke i lënë këto dy liqene në të njëjtën situatë duke mos ndaluar aktivitetin dëmtues të dy subjekteve mbi florën dhe faunën e liqeneve (*Trajtuar hollësisht në faqet 110-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 32: Stafi i AKZM të marrë masa të rritë sipërfaqet e ZM dhe duke shfrytëzuar të gjitha hapësirat ligjore në marrëdhënie me institucione të tjera, AKZM duhet të bëjë përpjekje të pandërprera deri sa të vendosë në standardet e duhura dy ekosistemet ujore në Liqeni i Seferanit dhe Liqeni i Degës në bashkinë Belsh.

Menjëherë

Gjetje 33: AKZM, me shkresën nr.825 prot. Datë 20.07.2017 drejtuar z.HC Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, ka kërkuar ndërhyrjen për ndalim të aktivitetit të një subjekti të paligjshëm privat, S.I i cili ushtronte aktivitet ekonomik shërbimi në ishujt e Ksamilit të cilët janë ZM, bazuar në konstatimin e AdZM Vlorë datë 13.06.2017 e cila kishte njoftuar edhe ISHMP Vlorë por deri në datë 05.07.2017 nuk ka ndonjë përgjigje nga ISHMP. Në paragrafin e fundit të shkresës, citohet: “... në zonën e Parkut të Butrintit janë identifikuar edhe ndërhyrje të tjera të paligjshme për të cilat AKZM po vazhdon procedurat për prishje ose largim”. Për sa më sipër nuk ka një informacion për gjendjen aktuale në Parkun e Butrintit nga ndërhyrjet e tjera të paligjshme (Trajtuar hollësisht në faqet 110-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 33.1: AKZM të ndërtojë një data-base dhe një hartë për të gjitha ZM ku të vendosë me shenja konvencionale të gjitha problemet kryesore që ka aty mjedisi, flora dhe fauna dhe këtë hartë duhet ta rifreskojë sipas gjendjes reale.

Menjëherë

Gjetje 34: AKZM me shkresat nr.1138/1 datë 4.12.2017 drejtuar Kryetarit të Bashkisë Bulqizë dhe shkresën nr.190 prot . datë 4.12.2017 drejtuar krye inspektorit të Qarkut Dibër, njofton se në Liqenin e Zi, Monument Natyre në Bulqizë, firma private “T” ka hedhur inerte në ngastrën nr.19 të ekonomisë pyjore të këtij liqeni pas hapjes së një tuneli, duke shkaktuar ndotjen e liqenit. Nuk ka informacion në dosje se çfarë është bërë në drejtim të ecurisë së këtij konstatimi për marrjen e masave zhdëmtuese e rehabilituese ndaj këtij dëmi (Trajtuar hollësisht në faqet 110-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 34.1: AKZM të ndërtojë një database dhe një hartë për të gjitha ZM ku të vendosë me shenja konvencionale të gjitha problemet kryesore që ka mjedisi, flora dhe fauna dhe këtë hartë duhet ta freskojë sipas gjendjes reale në Liqenin e Zi Shkodër.

Menjëherë

Gjetje 35: Sipas email-it datë 5.11.2018 dërguar nga përgjegjësi i sektorit të Monitorimit në AKZM, njoftohen AdZM Korçë, Fier dhe Kukës për të dërguar informacion në lidhje me një emisionin investigativ të emisionit Fix Fare të TCH tv në datën 10.05.2018, ku trajtohet fenomeni i gjuetisë së paligjshme të faunës së egër në qarqet Korçë, Lushnjë e Kukës. Kjo pasi gjuetarë të ndryshëm kanë ushtruar gjueti e peshkim të paligjshëm në ZM të Pogradecit, Kukësit, Korçës e Lushnjës. Është kërkuar forcimi i masave kundër këtij fenomeni të ndaluar me ligj pas moratoriumit, duke i këshilluar që: “ këto procese ligjore duhet të iniciohen nga AdZM-të dhe jo nga televizionet”. Nuk janë zbatuar kërkesat ligjore të nenit 1, 2, dhe neni 5 të ligjit nr.81/2017 “Për zonat e mbrojtura” (Trajtuar hollësisht në faqet 110-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 35.1: AKZM dhe AdZM-të të marrin masa të vazhdueshme për të ndaluar në çdo periudhë të vitit aktivitete të ndaluara në bashkëpunim të ngushtë edhe me institucionet e tjera përgjegjëse dhe të bashkëpunohet me organizatat joqeveritare dhe të vlerësohet çdo informacion i medieve të shkruar e audiovizive etj.

Në vijimësi

Gjetje 36: Nga shqyrtimi i dosjeve u konstatua plani i masave “Për parandalimin dhe mbrojtjen e pyjeve dhe kullotave në ZM nga zjarri për vitin 2016/2017” si edhe një shkresë drejtuar nga AKZM me nr. 812/1 datë 9.7.2018 ku flitet për planin e masave në këtë drejtim për vitin 2018.

Nga auditimi rezultoi se evidentohet një numër i lartë i rasteve të zjarreve në ZM që çojnë në përfundimin se planet e masave të hartuara nga AKZM përmbajnë shumë formalitet dhe nuk kanë dhënë rezultatet e duhura në parandalimin e zjarreve. AKZM ka për detyrë të përqendrohet në parandalimin e tyre. Nisur nga tabela e procesverbaleve të vitit 2015, 2016, 2017 dhe 2018 konstatojmë se janë mbajtur shumë procesverbale lidhur me zjarret në ZM (*Trajtuar hollësisht në faqet 110-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 36.1: AKZM Tiranë të marrë masa dhe të hartojë e kërkojë përmirësime ligjore në drejtim të caktimit dhe zbatimit të diferencuar të sanksioneve më të forta, të cilat sigurojnë një mbrojtje efikase për zonat e mbrojtura nga zjarret, duke penguar e mos lejuar veprimtari të dëmshme që rrezikojnë e shkaktojnë ndryshimin e gjendjes natyrore të ekosistemit në to nisur nga veçoritë dhe specifikat e ZM-ve.

Brenda muajit Prill 2019

Gjetje 37: Nga auditimi rezulton se me një shkresë në janar të vitit 2016 shprehet edhe për dy lejet e hidrocentralit mbi kanionin e Osumit për Kompaninë e listuar “X & Y” shpk, si subjekt që kryen veprimtarinë e tij “jashtë rrejtit të Zonave të Mbrojtura”.

Por në kundërshtim me këtë përgjigje të mësipërme, me një shkresë tjetër të datës 08.05.2018 AKZM shprehet se “Godina e HEC ‘B1’ ndodhet brenda monumentit natyror “*Kanionet e Osumit i cili kohët e fundit është bërë një atraksion turistik për vizitorë vendas dhe të huaj dhe veçanërisht të zhvillimit të sportit ujor*” dhe në fund shprehet se AKZM është “*kundër zhvillimit të këtij aktiviteti*”.

AKZM është e detyruar nga Ligji nr. 81/2017, Neni 2 ku thuhet se “*Qëllimi i këtij Ligji nr. është të sigurojë mbrojtje të veçantë të zonave të mbrojtura mjedisore dhe përbërësve të rëndësishëm të biodiversitetit dhe të natyrës në to, nëpërmjet: b) zhvillimin dhe mbrojtjen e zonave të mbrojtura mjedisore, pasurive kombëtare me rëndësi të veçantë për vlerat e rralla e të pazëvendësueshme të ekuilibrave natyrorë, biodiversitetit, si detyrim në interes të brezave të sotëm dhe të ardhshëm*” (*Trajtuar hollësisht në faqet 110-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 37.1: AKZM, të marrë masa të menjëhershme të bashkëpunojë me MTM, për të qartësuar nëse zhvillimi edhe i aktiviteteve të tjera të këtij lloji është i pajisur me leje mjedisore apo jo. Gjithashtu të marrë masa me nisma juridike në drejtim të forcimit të sistemit ligjor për të qenë më efikas për mbrojtjen e ZM lidhur me licencimin e HEC-ve. AKZM për rastin konkret të marrë masa dhe të ndjekë në vijimësi masat për identifikimin e të gjitha kontratave të këtij lloji në zonat e mbrojtura, si dhe të kërkojë e të nxjerrë përgjegjësitë për titullarët dhe institucionet që kanë lidhur kontrata në dëm të ZM.

Brenda muajit Mars 2019

Gjetje 38: Laguna e Karavastasë ligjërisht është e mbrojtur, ndërsa praktikisht, nga auditimi në gjetjet e mëparshme u konstatua se përdoret pa kriter prej banoreve të Divjakës. Shumë kanale të ujërave të zeza të disa fshatrave përreth është konstatuar se ende derdhen në këtë lagunë. Gjithashtu, konstatuam se Laguna e Karavastasë gjendet në mënyrë permanente nën ndikimin e peshkimit të banorëve apo edhe të tjerëve, të cilët e përdorin këtë si mënyrë tregtimi, përgjegjësi kjo e stafit të AdzM Divjakë.

Sipas ligjit për zonat e mbrojtura, Neni 34 “Peshkimi në zonat e mbrojtura detare e bregdetare” citohet se: “*Në zonat e mbrojtura detare e bregdetare është i ndaluar peshkimi për qëllime tregtimi, referuar dispozitave të legjislacionit në fuqi për peshkimin dhe akuakulturën. Peshkimi tregtar lejohet vetëm në zonat e mbrojtura detare e bregdetare, pjesë e kategorive IV, V dhe VI, pas miratimit me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të AKZM-së të kushteve që duhet të zbatohet peshkimi në këtë zone*” (*Trajtuar hollësisht në faqet 110-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 38.1: AKZM në bashkëpunim e koordinim me AdZM të marrin masat e duhura ligjore dhe organizative më synim që ta ndalë procesin e degradimit dhe përdorimit pa kriter e pa leje të peshkimit si dhe ndotjen me derdhjen e ujërave të zeza në Lagunen e Karavastasë.

Në vijimësi

Gjetje 39: Nga auditimi u konstatua se nuk është vendosur dhe nuk ekziston territori buferik i zonës së menaxhimit të habitateve dhe llojeve me gjerësi 50 m nga kufiri i zonës sipas nenit 3/30 të ligjit nr.81/2017, ku citohet: “Zonë buferike” është hapësira e kufizuar, në periferi të zonës së mbrojtur mjedisore, që shërben për parandalimin ose zbutjen e ndikimeve ekologjike të dëmshme në mjediset dhe elementet e rëndësishme të zonës së mbrojtur”. Në rezervatet natyrore të menaxhuar ku mungon zona buferike futen Kune Vain, Rrushkulli, Pishë Poro, Karaburun*(Trajtuar hollësisht në faqet 110-135 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 39.1: AKZM në bashkëpunim e koordinim me AdZM-të të marrë masa për të vendosur, caktuar dhe kufizuar sipas standardit ligjor zonat buferike në rezervatet natyrore Kune-Vain, Rrushkulli, Pishë Poro, Karaburun, Ksamil, Divjakë etj., në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të funksioneve natyrore të tyre.

Brenda muajit Prill 2019

Gjetje 40: Nga auditimi u konstatua se AKZM ka trashëguar nga institucionet e tjera dhe administron **9 kontrata qiraje** për të cilat nuk është përmbushur detyrimi kontraktual nga qiramarrësit, duke i shkaktuar buxhetit të AKZM dëm ekonomik në vlerën **8,287,968 lekë**. *(Trajtuar hollësisht në faqet 20-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 40.1: AKZM të marrë masa për njoftimin dhe arkëtimin e detyrimeve nga 7 subjekte në vlerën **8,287,968 lekë**, respektivisht:

- vlera 397,508 lekë ndaj subjektit X SHPK në AdZM Kukës.
- vlera 28,000 lekë ndaj subjektit Y SHPK në AdZM Tiranë.
- vlera 410,550 lekë ndaj subjektit Z SHPK në AdZM Tiranë.
- vlera 811,234 lekë ndaj subjektit B SHPK në AdZM Dibër.
- vlera 1,440,000 lekë ndaj subjektit S, në AdZM Vlorë.
- vlera 2,700,000 lekë ndaj subjektit R SHPK në AdZM Vlorë.
- vlera 67,448 lekë ndaj subjektit A SHPK në AdZM Vlorë.
- vlera 1,886,580 lekë ndaj subjektit C SHPK në AdZM Gjirokastrë.
- vlera 546,648 lekë ndaj subjektit D SHPK në AdZM Gjirokastrë.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 germa (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr.44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. Ligjit nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”, të udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në **vlerën 75,609 lekë**. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim rillojaritjen dhe arkëtimin e dëmit në **vlerën 75,609 lekë**, si më poshtë:

Gjetje 1: AKZM në 13 raste për shumën 36,319 lekë përkatësisht: 6 raste në vitin 2017 me vlerën 29,811 lekë ka kryer pagesa nga banka dhe shpenzime për pagesa gjobash për regjistrim vjetor të vonuar dhe pajisje certifikatash pronësie të mjeteve motorike (autovetura, motorë etj), përkatësisht me urdhër shpenzimet nr.302, datë 11.12.2017, nr.304, datë 11.12.2017, nr.305, datë 11.12.2017, nr.312, datë 21.12.2017, nr.313, datë 11.12.2017, nr.314, datë 21.12.2017 dhe nr.318, datë 26.12.2017; si dhe në fundvitin 2015 për 7 raste për vlerën 6,508 lekë, janë kryer shpenzime për pagesa gjobash për tejkalim të afateve të kontrollit teknik të mjeteve motorike; pra shpenzime të kryera pa efektivitet në kundërshtim me ligjin nr. 9975, datë 28.7.2015 “Për Taksat Kombëtare” nenet 3, 4, 7 ligjin “Për Buxhetin”, pasqyruar në tabelën emërtuar:”Tabela e gjobave të paguara për tejkalim të afateve të kontrollit teknik të mjeteve” (Trajtuar hollësisht në faqet 30-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandim 1.1: AKZM Tiranë, Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa analizojë situatën e krijuar dhe të nxjerrë përgjegjësinë e të ndjekë hapat e duhur ligjor dhe gjithë shkallët procesit gjyqësor për arkëtimin e dëmit ekonomik në vlerën 36,319 lekë për shpenzime e likuidime për pagesë gjobash nga pagesat e vonuara të taksës regjistrimit dhe kontrolleve teknike.

Menjëherë

Gjetje 2: Nga verifikimi inventarit fizik të magazinës, nëpërmjet sondazhit për dy artikuj “goma automjetesh” dhe “vaj makine” të furnizuar dhe shlyer pagesa me urdhër shpenzimet nr. 117, datë 22.6.2018 për artikullin “Goma automjetesh” dhe nr.122, datë 26.06.2018 për artikullin “vaj makine, rezultoi një diferencë me vlerën totale 39,390 lekë, që i përket 4 goma x 5160 lekë = 20,640 lekë dhe 50 litra vaj x 375 lekë = 18,750 lekë, që përbën dëm ekonomik dhe ngarkon me përgjegjësi magazinierin, pasi është në kundërshtim pikën 37 dhe pikën 39 të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” Kreu II “Menaxhimi i riskut të lidhur me aktivet” “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” pika 37 dhe 39 (Trajtuar hollësisht në faqet 59-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 2.1: AKZM, nëpunësi autorizues të marrë masa për nxjerrjen e urdhrimit të zhdëmtimit ndaj personit materialisht përgjegjës për zhdëmtim të vlerës prej 39,390 lekë dhe arkëtimin e plotë të vlerës rezultuar si diferencë inventari fizik të magazinës në artikullin goma automjeti dhe vaj motorri makine.

Menjëherë

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Gjetje 1: Në prokurimin publik me objekt “Loti I, Ndërtim i Qendrës së Informacionit PK Dajt” me fond limit 21,480,285 lekë pa tvsh, KVO ka vlerësuar në papajtueshmëri me nenet 20, 23, 46, 53, 56 të ligjit nr.9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu VII i VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ka skualifikuar një ofertues i cili plotëson kriteret për kualifikim me devijime të vogla, duke shkaktuar përdorimin e fondeve publike me efekt financiar negativ në vlerën në vlerën 1,430,255 lekë pa tvsh (Trajtuar hollësisht në faqet 66-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 1: AKZM, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa të analizojë mangësinë dhe të nxjerrë përgjegjësitë, duke marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me efekt financiar negativ në vlerën 1,430,255 lekë, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike që është ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk cenojnë thelbin e zbatimit të kontratës.

Brenda muajit Shkurt 2019

C.1 TË ARDHURA TË MUNGUARA

Gjetje 1: Nga auditimi u konstatua se AKZM ka trashëguar nga institucionet e tjera dhe administron **9 kontrata qiraje** për të cilat nuk është përmbushur detyrimi kontraktual nga qiramarrësit, duke i shkaktuar buxhetit të AKZM dëm ekonomik në vlerën **8,287,968 lekë**. (Trajtuar hollësisht në faqet 20-23 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 1.1: AKZM të marrë masa për njoftimin dhe arkëtimin e detyrimeve nga 7 subjekte në vlerën **8,287,968 lekë**, respektivisht:

- vlera **397,508 lekë** ndaj subjektit **T SHPK** në AdZM Kukës.
- vlera **28,000 lekë** ndaj subjektit **SSHPK** në AdZM Tiranë.
- vlera **410,550 lekë** ndaj subjektit **Sh SHPK** në AdZM Tiranë.
- vlera **811,234 lekë** ndaj subjektit **B SHPK** në AdZM Dibër.
- vlera **1,440,000lekë** ndaj subjektit **S**, në AdZM Vlorë.
- vlera **2,700,000 lekë** ndaj subjektit **R SHPK** në AdZM Vlorë.
- vlera **67,448 lekë** ndaj subjektit **K SHPK** në AdZM Vlorë.
- vlera **1,886,580 lekë** ndaj subjektit **A SHPK** në AdZM Gjirokastrë.
- vlera **546,648 lekë** ndaj subjektit **E SHPK** në AdZM Gjirokastrë.

Menjëherë

Gjetje 2: AKZM Tiranë, në pasqyrat financiare dhe në evidencën kontabile të veprimtarisë të viti 2016 dhe viti 2017, nuk ka pasqyruar **detyrimet debitoare (shitesë)** të pashlyera në vlerën prej 3,997,175 lekë përkatësisht: vlera prej 1,576,443 lekë për vitin 2016 dhe vlera 2,420,732 lekë pashlyer në vitin 2017, që përbejnë detyrimet debitoare nga qiramarrësit sipas kontratave të qiradhënies të aseteve të AKZM me afat shtrirje kohore mbi 10 vjet, mosveprim në kundërshtim me ligjin nr.9228, datë 24.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe me UMF nr.26, datë 27.12.2007 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.12.2006”(Trajtuar hollësisht në faqet 63-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 2.1: AKZM Tiranë të marrë masat për kryerjen e kontabilizimeve, pasqyrimin dhe plotësimin me saktësi të formateve të bilancit vjetor 2018 të **detyrimeve debitoare (shitesë)** të pashlyera në vlerën prej 3,997,175 lekë përkatësisht: 1,576,443 lekë të vitit 2016 dhe vlera 2,420,732 lekë pashlyer në vitin 2017, si dhe të listohen e ndiqen në dinamikë detyrimet debitoare nga qiramarrësit sipas kontratave të qiradhënies të aseteve të AKZM me afat shtrirje kohore mbi 10 vjet.

D. MASA DISIPLINORE

-Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2017 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr.178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim-marrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë **Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor** të vlerësojë, në varësi të analizës së përgjegjësive, shkallën e përgjegjësisë për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si më poshtë:

a. “Vërejtje” deri në “ Vërejtje me paralajmërim”, për **6 punonjësit** e mëposhtëm:

1. Për znj. V D me detyrë Drejtore e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse për mangësitë e shkeljet në hartimin, zbatimin e buxhetit, programimit parashikimit me rezerva, mungesën e nxjerrjes akteve nënligjore, mbledhjes së të ardhurave dhe për viti 2016, 2017 dhe 9/mujor 2018,
-Për mangësitë parashikim me rezerva, evidentimin ndjekjen dhe mosrealizimin e Buxhetit të fondit të pagave për vitet 2016, 2017 dhe 9/mujorin viti 2018

-Për mangësitë dhe parregullsitë në mbajtjen e ditarit të bankës viti 2015-2018

- Për mangësitë e shkeljet në dokumentacionin justifikues 11 raste shpenzime riparim mirëmbajtje mjetesh, dhe 4 raste blerje mallrash, në cilësinë e Kryetarit Komisionit Blerje të vogla, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

-Për gjendje stoku të karburanteve me rezerva të panevojshme 1-3 vjet dhe pranim dokumentacion të parregullt të normativave të harxhimit të karburanteve ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr.30, datë 27.12.2011

- Për mos kryerje të inventarit të AQT dhe mosregjistrimi në ZVRPP në kundërshtim me U M F nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik

- Për mangësitë në hartimin nxjerrjen dhe relatimin e pasqyrave financiare të viti 2016 dhe 2017, trajtuar në Raportin përfundimtar dhe Aktkonstatimet nr. 1,2, 5, 8,11,12,

Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 3 procedurë prokurimi publik, konkretisht:

1. Procedura e prokurimit publik me objekt: “Loti 1, Ndërtim i Qendrës së Informacionit PK Dajt”.

2. Procedura e prokurimit publik me objekt: “Ndërtim Sistem Hidranti për izolimin dhe fikjen e zjarrit në PK Shebenik- Jabllanicë”.

3. Procedura e prokurimit publik me objekt: Ndërtim Sistem Hidranti për izolimin dhe fikjen e zjarrit në PK Divjakë-Karavasta”.

2. Për znj. A P, me Detyrë Drejtore e Drejtorisë së Menaxhim/Monitorimit dhe Projekteve, për:

-Për mos dokumentim, ndjekjen e zbatimin e projekteve sipas detyrave të përcaktuara në Rregulloren e AKZM dhe mungesë efience e efektiviteti në zbatimin e tyre;

- mangësitë e shkeljet në hartimin, zbatimin e buxhetit, programimit parashikimit me rezerva, mungesën e nxjerrjes akteve nënligjore, mbledhjes së të ardhurave,

- mangësitë e shkeljet në dokumentacionin justifikues në 1 rast në blerjen urdhër shpenzimin nr.109 riparim mirëmbajtje mjetesh, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Blerje të vogla, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, trajtuar në Raportin përfundimtar dhe Aktkonstatimet nr.1, 11,12,

3. Për znj. G C, me detyrë specialiste-Juriste Drejtorisë Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

-Për mangësitë e mungesën e nxjerrjes akteve nënligjore programimit parashikimit me rezerva, mbledhjes së të ardhurave

-Për mangësitë e shkeljet në dokumentacionin justifikues në 2 raste në blerjen urdhër shpenzimin nr.109, 494 dhe 2 raste hartim konfirmim procesverbal emergjence urdhër shpenzimet nr.21, nr.224 për riparim mirëmbajtje mjetesh, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Blerje të vogla, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Aktkonstatimet nr.1, 12,

Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 3 procedurë prokurimi publik, konkretisht:

1. Procedura e prokurimit publik me objekt: “Loti 1, Ndërtim i Qendrës së Informacionit PK Dajt”.

2. Procedura e prokurimit publik me objekt: “Ndërtim Sistem Hidranti për izolimin dhe fikjen e zjarrit në PK Shebenik- Jabllanicë”.

3. Procedura e prokurimit publik me objekt: Ndërtim Sistem Hidranti për izolimin dhe fikjen e zjarrit në PK Divjakë-Karavasta”.

4. Për z. D S, me detyrë përgjegjës i sektorit të monitorimit;

- Për hartim dokumentacion të parregullt të normativave të harxhimit të karburanteve e mos rishikim te tyre në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.210 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”

-Për mangësitë dhe shkeljet konstatuar në mos hartimin e një plani vjetor në lidhje me kontrollet që ushtrohen gjatë vitit. Bazat e të dhënave në AKZM janë akoma në proces krijimi dhe nuk janë të organizuara si duhet. Rrjedhimisht nuk ka plane vjetore, si dhe kontrollet për monitorime shtrihen në çështjet që dalin gjatë proceseve të punës, pa qenë të strukturuar sipas rëndësisë dhe periudhave të vitit, kjo lidhur me jetën e egër të florës e faunës në zona, e cila ndryshon si nga zona në zonë dhe nga një periudhë e vitit në tjetrën. Për mangësinë e të dhënave në lidhje me subjektet të cilat ushtrojnë veprimtari në zonat e mbrojtura, të cilët të vetë monitorojnë aktivitetin që ushtrojnë, sipas kërkesave të specifikuar nga AKZM-ja në zbatim të programit të secilës zonë dhe t’ia njoftojnë këto ADZM-së përkatëse, gjë e cila është në kundërshtim me pikën 2, neni 60 i ligjit nr. 81/2017 “Për zonat e mbrojtura”, trajtuar në Raportin përfundimtar dhe Aktkonstatimet nr.1, 2

Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 3 procedurë prokurimi publik, konkretisht:

1. Procedura e prokurimit publik me objekt: “Loti 1, Ndërtim i Qendrës së Informacionit PK Dajt”.

2. Procedura e prokurimit publik me objekt: “Ndërtim Sistem Hidranti për izolimin dhe fikjen e zjarrit në PK Shebenik- Jabllanicë”:

3. Procedura e prokurimit publik me objekt: Ndërtim Sistem Hidranti për izolimin dhe fikjen e zjarrit në PK Divjakë-Karavasta”.

-Pasi në cilësinë e kryetarit të komisionit të mbrojtjes nga zjarret në ZM nuk ka ndjekur e dokumentuar në bashkëpunim me strukturat e tjera si AdZM, Pushtet vendor, organe ligjzbatuese etj., në marrjen e masave nga dëmtimet prej zjarreve, sipas përcaktimeve në rregullore.

-Për mangësitë e shkeljet në dokumentacionin justifikues në 1 rast në blerjen urdhër shpenzimin nr. 494 dhe në 2 raste hartimin e konfirmimin e procesverbaleve të emergjencës urdhër shpenzimin nr.21 dhe nr.224 riparim mirëmbajtje mjetesh, në cilësinë e anëtarit të Komisionit Blerje të vogla, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

5. Për z. S Xh, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të menaxhimit,

-Për mangësitë në dokumentimin lidhur me planifikimin vjetor në bashkëpunim me sektorët e tjerë për menaxhimin e zonave të mbrojtura; për inventarizimin, mbarështimin e pyjeve dhe kullotave në ZM.

-Për mangësitë e shkeljet në dokumentacionin justifikues procesverbalit marrjes dorëzim në blerje goma vaj makinash urdhër shpenzimin nr.117, në cilësinë e anëtarit të Komisionit marrjes në dorëzim,, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

- Për hartim dokumentacion të parregullt të normativave të harxhimit të karburanteve e mos rishikim te tyre në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 08.07.210 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, trajtuar në Raportin përfundimtar dhe Aktkonstatimet nr.1, 2

-Për mangësitë e konstatuara në mos krijimin deri më tani të inventarit ose databazës së të gjithë florës dhe faunës në territorin e zonave të mbrojtura, në kundërshtim me pikën 4/d, neni 38, ligji nr.81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”; për mosndjekjen e zbatimit të Planeve të Menaxhimit për ato ZM që e kanë një të tillë. Planet e menaxhimit të hartuara me qëllimin e ruajtjes dhe përmirësimit të gjendjes së një ZM-je nuk ndiqen nga AdZM-të përkatëse dhe AKZM, e cila nuk ka asnjë bazë të dhënash në drejtim të ndjekjes e zbatimit të këtyre PM-ve, duke mos zbatuar

kështu nenin 43 të ligjit nr. 81/2017, “Për Zonat e Mbrojtura”. Për mos ndjekjen si dhe sa duhet të çështjes Kilic Aquaculture, duke qenë se nuk mund të pretendohet se një subjekt nëse nuk prek tokë atëherë nuk është në zonë të mbrojtur dhe nuk ka nevojë të monitorohet.

Në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 1 procedurë prokurimi publik, konkretisht:

1. Procedura e prokurimit publik me objekt: “Loti 1, Ndërtim i Qendrës së Informacionit PK Dajt”.

Punonjësit e mësipërm *znj.V D, znj.GC, z.D S, dhe z.S Xh* sipas praktikave që kanë administruar në pozicionin e anëtarit të KVO, kanë kryer shkelje administrative në papajtueshmëri me nenet 20, 23, 46, 53, 54 të ligjit nr.9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu VII i VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar(*Trajtuar hollësisht në faqet 66-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

D.2 Për punonjësit që janë kompetencë e Ministrisë

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të neni 58, “Llojet e masave disiplinore” të ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2017 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr.178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim-marrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë **Ministrinë të Turizmit dhe Mjedisit** për vlerësimin dhe përcaktimin e masës disiplinore mbështetur në rezultatet e auditimit sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit për:

- *z. ZD me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i AKZM,*

D.3. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat “e” dhe “ç” të neni 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kombëtare të Zonave të Mbrojtura**, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH për periudhën 01.01.2016 deri më 30.09.2018, i lihet në kompetencë përcaktimi i llojit të masës dhe të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore, **për punonjësit e mëposhtëm:**

z. FN, me detyrë Drejtor i AdZM Berat,

z. BH me detyrë Drejtor i AdZM Kukës,

z. B Q, me detyrë Drejtor i AdZM Dibër,

z. P T, me detyrë Drejtor i AdZM Lezhë,

znj.L L, me detyrë Drejtor i AdZM Vlorë

z.I V, me detyrë Drejtor i AdZM Tiranë për mosmarrje masash ne menaxhimin, ruajtjen e zonave të mbrojtura nga dëmtimet(Trajtuar hollësisht në faqet 114-119 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-Për z. N H, me detyrë përgjegjës sektorit të monitorimit në ADZM Vlorë, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 1 procedurë prokurimi publik, konkretisht:

1. Procedura e prokurimit publik me objekt: "Loti 1, Ndërtim i Qendrës së Informacionit PK Dajt".

Në pozicionin e anëtarit të KVO, ka kryer shkelje administrative në papajtueshmëri me nenet 20, 23, 46, 53, 54 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, kreu VII i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. *(Trajtuar hollësisht në faqet 66-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

- Për hartim dokumentacion të parregullt të normativave të harxhimit të karburanteve e mos rishikim te tyre në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik", trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Aktkonstatimi nr.2.

10. Për z. E S, me detyrë shofer,

-Për mangësitë e shkeljet në dokumentacionin justifikues procesverbalit marrjes dorezim në blerje goma vaj makinash urdhër shpenzimin nr.117, në cilësinë e anëtarit të Komisionit marrjes në dorëzim, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", trajtuar në Raportin përfundimtar dhe Aktkonstatimet nr.1,

F. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte ndërprerje e marrëdhënies së punës përkatësisht:

1. Për znj. EF, ish-specialiste për burimet njerëzore dhe pagat, deri mars 2018

-Për mangësitë në evidentimin ndjekjen dhe realizimin e Buxhetit të fondit të pagave për vitet 2016, 2017 dhe 9/mujorin viti 2018, trajtuar në Raportin përfundimtar dhe Aktkonstatimet nr.8,

G. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, AKZM Tiranë (Sektori/njësia e Administrimit të burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionarin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar

G.1 PËR INSPEKTORATIN E DEKLARIMIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTARESIT

Të kërkohet trajtimi i konfliktit të interesit për statusin e zotit Z D, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i

AKZM për projektin që ka fituar shoqata e drejtuar prej tij më parë dhe nëse ka funksione bashkëshortja apo personi tjetër i lidhur me të.

I. Sqarime: Grupi i auditimit nuk auditoi projektet me donatorë vendas dhe të huaj pasi në vlerësimin e marrëveshjeve, KLSH nuk kishte tagër ligjor për ta audituar, sepse në këto marrëveshje është cilësuar se projekti do të auditohet nga auditues të pavarur dhe me marrëveshje të palëve pjesëmarrëse në projekte

II. Shënim i Kryetarit: Pavarësisht përpjekjeve të Grupit të Auditimit dhe Drejtorit të Departamentit, ky auditim nuk i përmbushi pritmëritë. Auditimi vlerësohet dobët nga Kryetarii KLSH-së. Do të realizohet në një kohe të dytë, për vetë rëndësinë që ka institucioni në vitin 2019. Departamenti ta parashikojë në Planin vjetor

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit dhe Drejtoria Juridike, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R